

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6317
E premte, 21 maj 2021
çmimi 0.40 €

Palmeri: Vendimi për
Sali Berishën, mjet i luftës
së ShBA-së kundër
korrupsionit | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", AVNI SPAHIU | FAQE 4-5

SHKARKIMI I AMBASADORËVE, I DËMSHËM PËR DIPLOMACINË



Ish-ambasadori i Kosovës në ShBA dhe në Turqi, Avni Spahiu, e ka vlerësuar të dëmshëm për diplomacinë e Kosovës shkarkimin e 12 ambasadorëve me "çelës politik". Në këtë intervistë dhënë gazetës

"Epoka e re", ai ka thënë se një veprim i tillë dëmton funksionimin normal të misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës. Spahiu ka vlerësuar se zëvendësimi i ambasadorëve politikë është dashur të bëhet gradualisht dhe

jo në mënyrë të menjëhershme. Sipas tij, procesi i zëvendësimit të këtyre ambasadorëve duhet të ndodhë shpejt në mënyrë që dëmi në politikën e jashtme të Kosovës të jetë më i vogël

OPINION

ALBIN KURTI DHE ÇLIRIMI I
KOSOVËS NGA KRIMINELËT

F. 10

Shkruan:
Ismail SYLA



AKTUALE



BE-ja REKOMANDON TË LEJOHET
UDHËTIMI PËR TË VAKSINUARIT
NË BALLKAN | F. 2

PARAQITET APLIKACIONI
DIGJITAL 'LAJMËRO POLICINË' | F. 6

EKONOMI



DIALOGU ME DOGANËN,
I RËNDËSISHËM PËR LEHTËSIMIN
E OPERACIONEVE BIZNESORE | F. 9

PUNËTORËT E ATK-SË NË
GREVË, PEZULLOHEN SHËRBIMET
PËR NJË ORË | F. 9

SPORT

ZEQIRI LA KOSOVËN PËR
ZVICRËN, 'DARDANËT' E
SHPALLIN 'NON GRATA' | F. 12

OPOZITA E VLERËSON
VENDIM TË DËMSHËM
LARGIMIN E AMBASADORËVE
| FAQE 3

NUK KALON REZOLUTA PËR
RRITJEN E SHITESAVE NGA
PAKOJA KUNDËR COVIDIT
| FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Palmeri: Vendimi për Sali Berishën, mjet i luftës së ShBA-së kundër korrupsionit

WASHINGTON, 20 MAJ - Zëvendësndihmëssekretari i Shtetit për Evropën, Matthew Palmer, i ka thënë "Zërit të Amerikës", se vendimi i sekretarit të Shtetit, Antony Blinken, për ta përcaktuar publikisht ish-presidentin e Shqipërisë, Sali Berisha, si të përfshirë në korrupsion, është një prej mjeteve që ShBA-ja vë në përdorim për ta luftuar korrupsionin. "Ky është një ndër instrumentet që ne kemi për ta luftuar korrupsionin publik. Ne i qëndrojmë në krah popullit shqiptar kundër korrupsionit publik dhe përcaktimi i zotit Berisha, që e bën atë të pakualifikuar për një

vizë për në Shtetet e Bashkuara, i bën anëtarët e afërm të familjes së tij të pakualifikuar për viza drejt Shteteve të Bashkuara, është një dëshmi e këtij angazhimi", ka deklaruar zëvendësndihmës Sekretari i Shtetit.

Ai ka theksuar se Sali Berisha ka abuzuar me pozitën e besimit të publikut për ta pasuruar veten. "Berisha abuzoi me pozitën e besimit të publikut për ta pasuruar veten, për t'i pasuruar anëtarët e familjes së tij, për t'i pasuruar aleatët politikë dhe mbështetësit. Shtetet e Bashkuara e marrin çështjen e korrupsionit publik shumë seriozisht", është

shprehur Palmer.

Zyrtari i lartë amerikan u pyet edhe në lidhje me kohën e publikimit të këtij vendimi për ish-kryeministrin Berisha. "Nuk do t'i kushtoja rëndësi momentit kohor, por ajo që ka rëndësi është serioziteti me të cilin e marrin Shtetet e Bashkuara çështjen e korrupsionit publik. Kjo është një dëshmi e angazhimit tonë për t'i përdorur ato instrumente që kemi të disponueshme, përfshirë sanksione sipas nevojës, me qëllim forcimin e luftës ndaj korrupsionit publik dhe për t'u siguruar se ka llogaridhënie për ata që abuzojnë me besimin e



publikut", ka thënë Palmer. Të mërkurën Departamenti i Shtetit i ShBA-së ka njoftuar se u ka ndaluar hyrjen në territorin amerikan ish-presidentit dhe

ish-kryeministrin të Shqipërisë, Sali Berisha dhe anëtarëve të familjes së tij të ngushtë për shkak të përfshirjes së tij në korrupsion të gjerë.

Në bisedimet e larta ShBA - Rusi theksohet nevoja e dialogut

WASHINGTON, 20 MAJ - Shtetet e Bashkuara dhe Rusia kanë dallime serioze, por ende mund të gjejnë mënyra për të punuar së bashku. Kështu u tha pas takimit të sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken, me ministrin e Jashtëm të Rusisë, Sergei Lavrov në Islandë.

Kremlini tha se bisedimet ishin konstruktive dhe paraqesin një "sinjal pozitiv" për një samit të mundshëm midis presidentit Vladimir Putin dhe presidentit të ShBA-së, Joe Biden.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha se Moskë do t'i analizonte bisedimet përpara se presidenti Putin të marrë ndonjë vendim për takimin me Bidenin. Ai përshëndeti vendimin e ShBA-së për të



hequr dorë nga sanksionet kundër ndërtuesit të gazsjellësit midis Rusisë dhe Gjermanisë.

Ministri i Jashtëm, Lavrov, tha se ai shpreson që udhëheqësit e Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë do të gjenin mënyra për t'i përmirësuar marrëdhëniet

pavarësisht faktit se pikëpamjet e tyre "dallojnë shumë për situatën ndërkombëtare dhe qasjet se si duhet përmirësuar atë".

Një zyrtar amerikan tha se takimi ishte produktiv, por nuk kishte shënuar asnjë përparim dhe se angazhimet për

raportet mes dy vendeve do të vijojnë në javët dhe vitet e ardhshme.

Bisedimet mes Blinken dhe Lavrov u fokusuan në një sërë temash, duke përfshirë vendosjen ushtarake të Rusisë në dhe afër Ukrainës, konfliktin midis Armenisë dhe Azerbajxhanit, kërkesën për lirim të dy shtetasve amerikanë të mbajtur nga Rusia dhe samitin e planifikuar midis Biden dhe Putin.

Zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Ned Price, tha se Blinken nxiti Rusinë të lirojë dy ish-marinsat amerikanë, të burgosur në Rusi. Pavarësisht se Rusia ka njoftuar për tërheqje të trupave të saj nga kufiri me Ukrainën, Blinken gjatë takimit ka shprehur shqetësim në lidhje me këtë

çështje.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, gjithashtu ka ngritur çështjen e shëndetit të kritikut të arrestuar të Kremlinit, Aleksi Navalny dhe veprimeve të Moskës kundër Zërit të Amerikës dhe Radios Evropa e Lirë.

Blinken përsëriti se presidenti Biden dëshiron "një marrëdhënie të qëndrueshme me Rusinë" dhe se të dyja vendet mund të punojnë së bashku për trajtimin e pandemisë së koronavirusit, çështjen e ndryshimeve klimatike, programin për klimën dhe Iranin dhe Koresë së Veriut dhe luftën në Afganistan. "Kjo do të ishte mirë për njerëzit tanë, rusët dhe për botën", ka thënë Blinken.

BE-ja rekomandon të lejohet udhëtimi për të vaksinuarit në Ballkan

BRUKSEL, 20 MAJ - Qytetarët e vendeve të treta, përfshirë ata nga Ballkani Perëndimor, që janë vaksinuar me dy doza kundër koronavirusit në vendet e tyre, do të mund të udhëtojnë në Bashkimin Evropian pa kufizime.

Rekomandimi është bërë nga ana e Këshillit të Bashkimit Evropian të enjten (20 maj). BE-ja ka në plan të miratojë "certifikatat digjitale" për banorët e vendeve të Bashkimit Evropian të cilat do të shërbejnë për udhëtime brenda bllokut. Derisa të bëhet miratimi i tyre, BE-ja ka vendosur që t'i pranojë

certifikatat e lëshuara nga vendet e treta dhe ato duhet të përmbajnë një minimum të të dhënave, bazuar në legjislacionin kombëtar, që do ta dëshmojnë autenticitetin, vlefshmërinë dhe integritetin e dokumentit. "Nëse vendet e BE-së pranojnë prova të vaksinimit, ato në parim duhet t'i heqin kufizimet në udhëtimet jothelbësore për udhëtarët e vendeve të treta që kanë marrë dozën e dytë të vaksinave të miratuara nga Agjencia Evropiane e Barnave të paktën 14 ditë para arritjes në territorin e BE-së", thuhet në rekomandim.



Agjencia Evropiane e Barnave deri më tani ka miratuar për përdorim vaksinat e 'Pfizer/BionTech', 'Moderna', 'Johnson & Johnson' si dhe

'AstraZeneca'.

BE-ja, gjithashtu, miratoi rekomandimin për t'i hequr kufizimet e udhëtimit për vendet, të cilat në 14 ditët e

fundit, kanë regjistruar maksimumi 75 raste të të infektuarve në ditë për 100 000 banorë.

Deri më tani ky prag ka qenë 25 raste për 100 000 banorë.

BE-ja, gjithashtu, ka përditësuar listën e "shteteve të gjelbra", pra të atyre vendeve që konsiderohen të sigurta sa i takon përhapjes së koronavirusit të ri. Qytetarët e këtyre vendeve mund të lëvizin pa pengesa brenda BE-së.

Vendimi i ministrave të BE-së nuk është ligjërues i detyrueshëm pasi vendet anëtare, veç e veç vendosin nëse do t'i zbatojnë rekomandimet.

Opozita e vlerëson vendim të dëmshëm largimin e ambasadorëve

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD) gjatë kësaj jave ka përcjellë te presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, propozimin për lirim nga detyra dhe tërheqje nga misioni diplomatik për të gjithë ambasadorët e Republikës së Kosovës të emëruar politikisht. Bëhet me dije se bëhet fjalë për largimin e 12 ambasadorëve. Ky vendim i qeverisë Kurti e ka shqetësuar edhe opozitën. Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, dhe ai i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, kanë thënë se ky veprim i qeverisë Kurti do ta dëmtojë imazhin e Kosovës në botë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 MAJ - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD), Donika Gërvalla, ka thënë të enjten se lirimet e fundit nga detyra e ambasadorëve të emëruar mbi baza politike përbëjnë vetëm një hap në reformën e thellë që do t'i bëhet shërbimit diplomatik të Kosovës. "Lirimi nga detyra dhe tërheqja e ambasadorëve të emëruar politikisht është bërë në frymën e programit të miratuar qeveritar, i cili parashihet reformimin e shërbimit diplomatik të Republikës së Kosovës dhe respektimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Kosovës", ka thënë ajo përmes një deklarate të publikuar në rrjetin social "Facebook". Sipas Gërvallës, ky vendim krijon hapësirë të domosdoshme për përmbushjen e obligimit ligjor që së paku 50 për qind e emërimeve të ambasadorëve dhe drejtuesve të misioneve të jenë nga anëtarë të shërbimit të jashtëm të Kosovës. "Ky është vetëm një hap në reformën e thellë të shërbimit diplomatik të Kosovës. Ai do të pasohet nga vendimet e tjera në nivelin strukturor të ministrisë dhe do të mbështetet nga legjislacioni i ri, i cili do ta ristrukturojë shërbimin diplomatik sipas standardeve ndërkombëtare", ka thënë mes tjerash ajo.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, ka miratuar më 19 maj propozimin e Qeverisë së Kosovës për lirim të këtyre ambasadorëve.

Largimin nga pozita e ambasadorit e ka konfirmuar edhe Hajdin Abazi, ambasadori i Kosovës në Australi, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" të enjten. Abazi ka thënë në ditën që ka bërë fiks dy vjet nga prezantimi i kredencialeve në Australi, nga presidentja e Kosovës, Vjosa

Osmani, i ka shkuar dekreti për lirim nga detyra. "Para tre muajsh kam dorëzuar kredencialet në Zelandën e Re dhe kam qenë duke pritur edhe dorëzimin e kredencialeve në Republikën e Fixhit dhe Ishujt Kuk. Ka qenë një nder ta përfaqësojë Kosovën në këtë pjesë të botës, ku kuptova se sa i gabuar është trumbetimi i disa politikanëve në Kosovë se gjoja në botën perëndimore nuk i duan njerëzit e UÇK-së, por kjo nuk është e vërtetë. Guvernatori-Gjeneral Peter Cosgrove më 20 maj 2019 më priti me një respekt të veçantë pikërisht pse isha veteran i luftës çlirimtare të Kosovës", ka shkruar Abazi.

AMBASADORËT E LARGUAR

1. Beqë Cufaj - Gjermani
2. Nait Hasani - Shqiperi
3. Arber Vllahu - Çeki
4. Lirim Grejçevci - Holande
5. Shpend Kallaba - Hungari
6. Gezim Kasapolli - Kroaci
7. Avni Kastrati - Slloveni
8. Gjergj Dedaj - Maqedonia e Veriut
9. Hajdin Abazi - Australi
10. Ylber Hysa - Mali i Zi
11. Avni Arifi - Emiratet e Bashkuara Arabe
12. Amir Ahmeti - Katar

Ai ka shtuar më tej se mediat serbe dhe komuniteti serb në Australi kanë bërë presion që të mos akreditohet si ambasador për shkak se ka qenë pjesëtar i UÇK-së, por qeveria australiane, megjithatë, e ka akredituar, "për çka i jam shumë mirënjohës këtij vendi të madh mik". "Çuditërisht, dy vjet më pas, m'u sot më 20 maj 2021, Qeveria e Kosovës përcjell dekretin që më liron nga detyra e ambasadorit, pikërisht në gjysmë të mandatit, që nuk është praktikë e dinjitetshme në diplomaci!", shkruar Abazi.

Ai ka falënderuar për bashkëpunim shumë zyrtarë të dikasterëve të MPJD-së, të cilët, sipas tij, janë treguar gjithnjë të përkushtuar dhe efikas. "Kosova ka shumë sfida përpara, të cilave

mund t'u dilet ballë vetëm me një politikë konstruktive, që respekton vlerat, punën, angazhimin dhe kontributin e secilit veç e veç, duke i ruajtur e çmuar ato e jo duke i konsideruar si kundërshtarë edhe kur nuk janë", ka shkruar Hajdin Abazi.

Ndaj këtij vendimi ka reaguar edhe ambasadori në Shkup i Kosovës, Gjergj Dedaj. Ai ka thënë se nuk do ta pranojë vendimin për shkarkim. "Në Kosovë po instalohet diktaturë. Do të jem ambasador deri në fund të mandatit ligjor", ka thënë Dedaj.

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, e ka konsideruar suspendim të politikës së jashtme të Kosovës,

propozimin e Qeverisë së Kosovës për lirim nga detyra të të gjithë ambasadorëve të Kosovës "të emëruar politikisht". Sipas Hoxhaj, njëherësh ish-ministër i Punëve të Jashtme në Kosovë, ky vendim përbën skandalin më të madh në politikën e jashtme. "Qeveria Kurti, me veprimin e djeshëm për kthimin e ambasadorëve me 'çelës politik', e ka suspenduar politikën e jashtme. Në 23 misione diplomatike, Republika e Kosovës nuk ka ambasadorë. Kjo përbën skandalin më të madh në Politikën e Jashtme të Kosovës. Largimi i përnjëhershëm i ambasadorëve me 'çelës politik' është i paprecedent, i pamatur, i paanalizuar mirë. Veprime të tilla kamikaze e dëmtojnë imazhin e Kosovës në botë, e zbehin subjektivitetin ndërkombëtar dhe i përmbysin të arriturat e dy dekadave të fundit në diplomaci", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka reaguar në lidhje me shkarkimin e ambasadorëve nga presidentja Vjosa Osmani, me iniciativë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Haradinaj përmes një postimi në

"Facebook" ka thënë se ky vendim është i papjekur politikisht dhe do të ketë ndikime negative në politikën e jashtme të Kosovës. "Vendimi i sotëm i presidentes së Kosovës, me nismën e ministres së Jashtme, për lirim nga detyra të një numri ambasadorësh të Kosovës, është i paprecedent dhe i papjekur politikisht, që do të ketë ndikime negative në politikën e jashtme të Kosovës. Largimi i paparalajmëruar i ambasadorëve të Kosovës, në mes të detyrës, në një periudhë të sfidave për shtetësinë e Kosovës, e dobëson pozitën e saj dhe e dëmton angazhimin për ndërtimin e partneritet serioz me shtetet pritëse", ka thënë Haradinaj.

Procedurat ligjore për emërimin e ambasadorëve të rinj marrin kohë. Pas propozimit të Ministrisë së Jashtme, që bëhet në koordinim me kryeministrin, emrat për ambasadorë dërgohen në Komisionin për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Kosovës. Ky komision pastaj i dërgon emrat në Presidencë, ku pason dekretimi nga ana e presidentit të Republikës. Por, procedura nuk përfundon me kaq. Shteti pranues duhet ta japë pëlqimin për ambasadorin e ri, procedurë kjo që mund të marrë disa muaj kohë.



FLET PËR "EPOKËN E RE", AVNI SPAHIU

Shkarkimi i ambasadorëve, i dëmshëm për diplomacinë

Ish-ambasadori i Kosovës në ShBA dhe në Turqi, Avni Spahiu, e ka vlerësuar të dëmshëm për diplomacinë e Kosovës shkarkimin e 12 ambasadorëve me "çelës politik". Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se një veprim i tillë dëmton funksionimin normal të misionëve diplomatike të Republikës së Kosovës. Spahiu ka vlerësuar se zëvendësimi i ambasadorëve politikë është dashur të bëhet gradualisht dhe jo në mënyrë të menjëhershme. Sipas tij, procesi i zëvendësimit të këtyre ambasadorëve duhet të ndodhë shpejt në mënyrë që dëmi në politikën e jashtme të Kosovës të jetë më i vogël

përnjëherë të largohen 12 ambasadorë", është shprehur ai.

Ish-ambasadori i Kosovës në Uashington ka thënë se nuk ka pasur ndonjë arsye për këto shkarkime. "Siç po shihet, lirimi i tyre nga detyra është bërë duke mos pasur asnjë vlerësim të punës së tyre. Nuk është e domosdoshme që të bëhet një analizë apo vlerësim i punës së tyre por, faktikisht, nuk ka pasur ndonjë arsye që do të ishte bazë për lirim të tyre nga detyra", ka deklaruar Spahiu. Sipas tij, procesi i zëvendësimit të këtyre ambasadorëve duhet të ndodhë shpejt në mënyrë që të mos krijohet një problem më i madh në aspektin e funksionimit normal të shërbimit diplomatik të Kosovës.

Spahiu ka paralajmëruar se zëvendësimin e këtyre ambasadorëve qeveria aktuale

do ta bëjë me ambasadorë me "çelës politik". "Ligji aktual thotë se raporti i ambasadorëve politikë me ata të karrierës duhet të jetë 50 me 50. Nuk besoj se kjo qeveri do të heqë dorë prej këtij raporti. Pra, sigurisht se edhe kjo qeveri do t'i emërojë ambasadorët e vet politikë. Përzgjedhja që duhet ta bëjnë varet prej tyre. Nuk do të hyjë në atë se çfarë profilesh do të duhet të zgjedhin", ka thënë Spahiu.

"Epoka e re": Z. Spahiu, me kërkesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, presidentja Vjosa Osmani ka liruar nga detyra 12 ambasadorë të cilët kanë qenë të emëruar politikisht. Si e keni parë këtë veprim të institucioneve të Kosovës?

Spahiu: Nëse shikohet nga aspekti formal ligjor këtu nuk ka ndonjë shkelje, sepse këtë ia mundëson ligji. Një parti e re

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 20 MAJ - Ish-ambasadori i Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe në Turqi, Avni Spahiu, ka kritikuar veprimin e institucioneve të politikës së jashtme të Kosovës për t'i liruar nga detyra 12 ambasadorë politikë. Ai ka thënë se shkarkimi përnjëherë i këtyre ambasadorëve është i dëmshëm për diplomacinë e Kosovës.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Spahiu ka vlerësuar se zëvendësimi i tyre është dashur të bëhet në mënyrë graduale. "Natyrishet se kjo ndikon në politikën e jashtme të Kosovës, pra e dëmton atë. Ka mundur që zëvendësimi i ambasadorëve të bëhet në mënyrë graduale duke filluar prej atyre që kanë mbushur mandatin dhe pastaj me të tjerët gradualisht", ka thënë Spahiu.

Ai ka bërë me dije se të ngarkuarit me punë nuk mund

të veprojnë si ambasadorët fuqplotë. "Dihet që në disa vende Kosova nuk ka pasur ambasadorë dhe me shkarkimin e këtyre ambasadorëve shtohet numri i vendeve që Kosova nuk ka ambasadorë dhe po vepron me të ngarkuar me punë. Kjo është një e metë për diplomacinë e Kosovës sepse të ngarkuarit me punë nuk janë të plotfuqishëm dhe nuk janë krejtësisht të qasshëm në vendet ku shërbejnë. Prandaj, po them se është veprim i dëmshëm që

që vjen në pushtet është normale të kërkojë shkarkimin apo zëvendësimin e ambasadorëve politikë, mirëpo largimi i dhjetëra apo më shumë ambasadorëve përnjëherë e dëmton funksionimin normal të misioneve diplomatike.

“Epoka e re”: Sa ndikon në politikën e jashtme të Kosovës largimi i një numri kaq i madh i ambasadorëve?

Spahiu: Natyrisht se ndikon në politikën e jashtme të Kosovës, pra e dëmton atë. Ka mundur që zëvendësimi i ambasadorëve të bëhet në mënyrë graduale duke filluar prej atyre që kanë mbushur mandatin dhe pastaj me të tjerët gradualisht. Dihet se në disa vende Kosova nuk ka pasur ambasadorë dhe me shkarkimin e këtyre ambasadorëve shtohet numri i vendeve që Kosova nuk ka ambasadorë dhe po vepron me të ngarkuar me punë. Kjo është një e metë për diplomacinë e Kosovës, sepse të ngarkuarit me punë nuk janë të plotfuqishëm dhe nuk janë krejtësisht të qasshëm në vendet ku shërbejnë. Prandaj, po them se është veprim i dëmshëm që përnjëherë të largohen 12 ambasadorë.

“Epoka e re”: A është dashur që para se të merret ky vendim të bëhet një vlerësim i punës i

këtyre ambasadorëve?

Spahiu: Siç po shihet, lirimi i tyre nga detyra është bërë duke mos pasur asnjë vlerësim të punës së tyre. Nuk është e domosdoshme që të bëhet një analizë apo vlerësim i punës së tyre por, faktikisht, nuk ka pasur ndonjë arsye që do të ishte bazë për lirimin e tyre nga detyra. Gjithashtu, problemi është edhe me ligjin ekzistues, sepse fillimisht Ligji për Shërbimin e Jashtëm ka qenë me një raport 30 për qind e ambasadorëve duhet të jenë politikë, kurse 70 për qind e tyre duhet të jenë diplomatë të karrierës. Pastaj u ndryshua ligji dhe ky raport është bërë 50 me 50. Me sa di,

me draftligjin që është duke u punuar tani është paraparë që të kthehet raporti 30 me 70, pra shumica të jenë ambasadorë të karrierës. Kjo flet edhe për këtë fakt se nuk është mirë që raporti të jetë 50 me 50.

“Epoka e re”: Në 23 misione diplomatike tani Republika e Kosovës nuk ka ambasadorë. Mund të ketë pasojë për diplomacinë një vakum i tillë?

Spahiu: Shpresoj që ky vakum do të plotësohet së shpejti në mënyrë që të mos krijohet një problem më i madh në aspektin e funksionimit normal të shërbimit diplomatik të Kosovës. Sa më gjatë që të shkojë

ky moszëvendësim atëherë dëmi do të jetë më i madh për Kosovën.

“Epoka e re”: Si mendoni se duhet të bëhet zëvendësimi i tyre? Duhet të zëvendësohen prapë me ambasadorë politikë?

Spahiu: Ligji aktual thotë se raporti i ambasadorëve politikë me ata të karrierës duhet të jetë 50 me 50. Nuk besoj se kjo qeveri do të heqë dorë prej këtij raporti. Pra, sigurisht se edhe kjo qeveri do t’i emërojë ambasadorët e vet politikë. Përzgjedhja që duhet ta bëjë varet prej saj. Nuk do të hyj në atë se çfarë profilesh duhet të zgjedhë.

“Epoka e re”: A është praktikë e mirë që kur të ndërrohen pushtetet, të ndërrohen edhe ambasadorët politikë?

Spahiu: Ne e kemi krijuar ligjin e tillë, i cili lejon këtë raport të ambasadorëve politikë me ata të karrierës. Pasoja e atij ligji po i vuajmë edhe tani. Madje ka pasur rast që numri i ambasadorëve politikë ka shkuar deri në 70 për qind, pra përtej asaj që ka lejuar ligji. Ky problem do të vazhdojë me çdo qeveri që do të vijë, sepse baza ligjore është e tillë. Shpresoj se do të bëhet ndryshimi i ligjit aktual, pra të bëhet që 70 për qind e ambasadorëve të jenë të karrierës, kurse 30 për qind të jenë politikë.



Nuk kalon rezoluta për rritjen e shtesave nga pakoja kundër Covidit

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 MAJ - Me 22 vota për, 56 kundër dhe 1 abstencion Kuvendi nuk e ka miratuar rezolutën e propozuar nga AAK-ja për rishqyrtimin e vendimit të qeverisë për uljen e shtesave të pensionistëve, stafit shëndetësor dhe institucioneve të sigurisë. Për këtë deputetët kanë ftuar të enjten në interpelancë ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati. Opozita e ka kritikuar qeverinë Kurti për ndalimin e shtesave për skemat sociale duke kërkuar që ky vendim të ndryshohet. Ministri Murati para deputetëve ka thënë se të thuhet se ka pasur zbritje të shtesave është gabim logjik. “Të thuhet se ka pasur zbritje do të duhej të nënkuptonte se ka pasur një vendim për shtesa për muajin prill. Sa kanë qenë të parapara shtesat për muajin prill? Vendimin që e kam flet për

janar, shkurt dhe mars. Të thuhet se ka pasur zbritje të shtesave është gabim logjik, sepse në muajin prill nuk ka pasur shtesa. A është kjo me të vërtetë brengë reale e opozitës apo është populizëm”, ka thënë Murati.

Propozuesi i interpelancës, shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka propozuar një rezolutë që shtesat për këto kategori të kthehen në shumën e njëjtë paraprake. “Vendimi i Qeverisë së Kosovës, i udhëhequr nga Albin Kurti për shtesat për skemat pensionale dhe sociale, personelin shëndetësor dhe zyrtarët policorë, është vendimi më skandaloz përmes të cilit ka shpërfillur dhe injoruar shëndetin dhe mirëqenien e 150 mijë pensionistëve, mbi 13 mijë staf profesional shëndetësor që qëndrojnë çdo ditë në vijën e parë të frontit me pandeminë Covid-19 dhe 9 911 policë dhe staf tjetër të sigurisë që për çdo ditë merren me sigurinë publike e që në mënyrë



të drejtpërdrejtë e rrezikojnë jetën e tyre dhe të familjarëve të tyre. A duhet të ishte ky një ndër vendimet e para të qeverisë Kurti? Sigurisht që jo! Prandaj, i rekomandoj Qeverisë së

Kosovës, që vendimet për mosvazhdimin e financimit të shtesave, veçanërisht për këto tri kategori, janë shumë të rëndësishme të anulohen dhe të nxirren vendime që e vazhdojnë

financimin e tyre dhe e shoh mundësinë e rritjes së shtesave fillimisht për këto kategori”, ka thënë Tahiri para votimit të kësaj rezolute e cila nuk mori përkrahjen e deputetëve.

Shërbime më të lehta komunale në Prizren

PRIZREN, 20 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Administratës, Osman Hajdari, kanë bërë përrurimin e projektit për infografikë dhe sinjalizim përmes të cilit qytetarët do të informohen në mënyrë më të lehtë në lidhje me procedurat dhe shërbimet komunale. Me

këtë rast, kryetari Haskuka ka thënë se duke e funksionalizuar këtë projekt, tanimë Komuna e Prizrenit ka përmbyshur edhe kriterin e fundit të Bankës Botërore për transparencë dhe llogaridhënie. Po ashtu, kryetari Haskuka ka theksuar se aktualisht janë duke punuar edhe për rregullimin e zyrave të tjera të

Administratës Komunale në mënyrë që punonjësve t'i sjellin një ambient sa më të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve të punës. Haskuka ka falënderuar drejtorin Hajdari për përkushtimin e dhënë për realizimin e reformave të thella për ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarë.



Komuna e Mitrovicës përfiton grant prej 324 mijë eurosh nga DEMOS-i



Mitrovicë, 20 maj (ER) - Në kuadër të Grantit të Performancës, nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, ka nënshkruar marrëveshjen për mirëkuptim dhe financim, ku Komuna e Mitrovicës, falë performancës së saj, është përfituese e një granti në vlerë prej 324 073.00 eurosh nga projekti i DEMOS-it, i cili është financiar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim dhe MAPL në kuadër të projektit i cili ka për qëllim të

ofrojë asistencë teknike për komunën, me qëllim të përmirësimit të performancës. Nënkryetari Mujka ka falënderuar DEMOS-in për mbështetjen dhënë për Komunën e Mitrovicës, në të njëjtën kohë ka shprehur gatishmërinë institucionale për ta rritur performancën komunale në të ardhmen. Mjetet e këtij granti do të përdoren për realizimin e projektit "Ndërtimi i urës të Liqeni Artificial dhe rregullimin e hapësirës përreth

liqenit" në vlerë totale prej 485.000.00 eurosh, ku shuma e ndarë nga GPK për vitin 2021 nga DEMOS është 324 073.00 euro, ndërsa komuna nga buxheti vjetor do ta financojë këtë projekt në shumën prej 160 927.00 eurosh. Ndërsa qëllimi i grantit të performancës është stimulimi i komunave për përmirësimin e mëtutjeshëm të performancës së tyre në fushat e qeverisjes demokratike, menaxhimit komunal, transparencës dhe integritetit.

Aplikacioni digjital 'Lajmëro policinë'

PRISHTINË, 20 MAJ (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj ka shpallur aplikacionin digjital "Lajmëro policinë", i cili ofron mundësi shumë të mira kontakti të qytetarëve me policinë për raportimin e rasteve nga më të ndryshmet. Shpjegimet dhe udhëzimet më të hollësishme lidhur me këtë aplikacion i ka bërë të enjten drejtori i DRP-së të Ferizajt, nënkolonel Basri Shabani, në dy televizionet lokale

të Ferizajt.

Ai ka shpjeguar se përmes kësaj platforme elektronike qytetarëve iu mundësohet t'i raportojnë të gjitha rastet në Policinë e Kosovës, duke ndjekur disa hapa për përdorimin e këtij aplikacioni, si një alternativë e re, e pakufizuar në kohë, mundësi dhe territor. Përmes aplikacionit qytetari vetëm brenda pak sekondash mund të ndajë informacione me policinë. Aplikacioni ofron

transparencë, konfidencialitet, pasi që të gjitha raportimet dokumentohen dhe denoncimi i qytetarëve mund të mbetet anonim, varësisht nga vetë përzgjedhja e qytetarit. Me këtë rast, Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj fton të gjithë qytetarët që të shkarkojnë këtë aplikacion në telefonat e tyre dhe për të gjitha rastet kriminale, pa asnjë hezitim, ta njoftojnë policinë.



Për herë të parë në Ballkan organizohet gara më e madhe për biznese të gjelbra



KAMENICË, 20 MAJ (ER) - Rrjeti i Bonevet në Kosovë, në bashkëpunim me Komunën e Kamenicës, janë duke realizuar konkursin më të madh të ideve të gjelbra të biznesit në Kosovë. Idetë më të mira dhe premtuese do të përzgjidhen nga vlerësuesit vendorë dhe qendra e Climate

Launchpad në Holandë. Ata pastaj do të mbajnë një punëtori intensive treditore online me trajnerë ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë. Në këtë punëtori të gjithë pjesëmarrësit do të punojnë për avancimin dhe zhvillimin e ideve të tyre në biznesplan. Në finalen ndërkombëtare

parashihen çmime për bizneset më të mira, rrjetëzim, ekspozim te konsumatorët tuaj dhe investime kapitale. Deri më tash përmes Climate Launchpad biznese të reja kanë arritur të marrin më shumë se 100 milionë euro investime.

Në Herticë shënohet Dita Botërore e Bletës

PODUJEVË, 20 MAJ (ER) - Komuna e Podujevës, në bashkëpunim me Shoqatën e Bletarëve "Llapi", kanë shënuar 20 majin - Ditën Botërore të Bletës me një manifestim me bletarë llapjanë. Në këtë aktivitet morën pjesë nënkryetarja e komunës, Marigona Lahu,

dhe drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Vigan Salihu. Para të pranishmëve folën nënkryetarja Lahu dhe kryetari i Shoqatës së Bletarëve "Llapi", Raif Muqolli. Nënkryetarja Lahu ka thënë se ndihet e lumtur që është

në mesin e bletarëve të vyeshëm llapjanë për ta shprehur gatishmërinë e ekzekutivit lokal për mbështetje të vazhdueshme për sektorin e bletarisë, sektor i cili për çdo vit është duke shtuar numrin e shoqërive të bletëve si dhe numrin e fermerëve që po

merren me këtë veprimtari. "Në angazhimin tonë si qeverisje e re lokale kemi zhvilluar takime me instanca qendrore dhe me partnerë ndërkombëtarë, për të siguruar mbështetje edhe më të madhe për ju, përtej planifikimeve tona buxhetore sepse, siç e dini edhe ju, ky



buxhet nuk është as për së afërmi i mjaftueshëm për kërkesat dhe nevojat tuaja", ka thënë Lahu.

237 pacientë me Covid janë të shtrirë në spitalet e Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 MAJ - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe private me metodën RAT janë testuar gjithsej 3 134 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 55 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar dy raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Prishtinë një rast (73 vjeç), Skenderaj një rast (63 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 107 120 raste nga 582 797 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 2 237 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 331 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 100 943 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 940.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 17 raste, Gjakovë 8 raste, Mitrovicë 5 raste, Podujevë 5 raste, Pejë 4 raste, Prizren 4 raste, Gjiilan 3 raste, Malishevë 2 raste, Vushtrri 2 raste dhe me nga një rast komunat Fushë-Kosovë, Kaçanik, Obiliq, Suharekë dhe Viti.

Në klinikat e Covid të QKUK-së dhe në spitalet e përgjithshme po trajtohen 237 pacientë. Sipas raportit të punës për datën 20 maj 2021, 139 pacientë janë të konfirmuar me Covid-19. "11 janë në gjendje të rënduar shëndetësore dhe 168 janë nën asistim të oksigjenoterapisë", ka njoftuar QKUK-ja.

Gjatë ditës së mërkurë, në sallën "1 Tetori" në Prishtinë dhe në 25 komuna të Kosovës janë dhënë 2 919 vaksina



kundër Covid-19, ndërsa totali i vaksinave në nivel ka arritur në 53 115 vaksina.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se procesi i vaksinimit ka vazhduar edhe të enjten dhe deri në mesditë të kësaj dite

numri i të vaksinuarve ka kaluar shifrën prej 54 000 ta vaksinuarve kundër Covid-19.

"Procesi i vaksinimit po kryhet sipas të gjithë parametrave të sigurisë dhe cilësisë nga ekipe të trajnuara në të gjithë vendin.

MSh-ja u bënë thirrje qytetarëve të çdo grupmoshe, që të regjistrohen dhe të aplikojnë për marrjen e vaksinës kundër Covid-19", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë.

Dita e Ditës së Malazezëve, Kurti: Kosovën dhe Malin e Zi i bashkon orientimi euroatlantik

PRISHTINË, 20 MAJ (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me zëvendëskryeministren Emilija Rexhepi, ka pritur të enjten në takim përfaqësuesit e komunitetit malazez në Kosovë, me rastin e 20 Majit, Ditës së Malazezëve të Kosovës dhe në prag të Ditës së Pavarësisë së Malit të Zi. Në takim ishin Lazar Radulović, kryetar i Shoqatës Malazeze "Lovçen" në Kosovë, Seid Haxhiq dhe Alen Mujeviq nga Drejtoria për Diasporë e Republikës së Malit të Zi, Biserka Gjurgjeviq nga Shoqata e Malazezëve në Podgoricë, si dhe ushtruesi i detyrës së ambasadorit të Malit të Zi në



Kosovë, Nikollë Lulçuraj. Në këtë takim miqësor kryeministri Kurti ka uruar

Ditën e Malazezëve të Kosovës, njëherësh edhe 21 Majin, Ditën e Pavarësisë së Malit të Zi, duke

thënë se Kosova dhe Mali i Zi e kanë përkrahur pavarësinë e njëri-tjetrit nga Serbia dhe të dy

shtetet i bashkon orientimi euroatlantik. "Ne duam që shqiptarët në Mal të Zi dhe malazezët në Kosovë t'i gëzojnë të gjitha të drejtat e tyre kolektive kulturore dhe politike si bazë e shëndoshë për marrëdhënie të mira në mes të dy shteteve tona fqinje, për një të ardhme më të mirë të të dy popujve", ka thënë kryeministri Kurti.

Pjesëmarrësit vlerësuan lart rëndësinë e këtij takimi dhe shënimin e kësaj dite si për afirmimin e pozitës së komunitetit malazez në Kosovë, ashtu edhe për ndërtimin e mirëbesimit dhe marrëdhënieve ndërfaqinësore midis dy vendeve dhe popujve.

Ish-ministri Numan Baliq dënohet me dy vjet burgim për sulm seksual

PRISHTINË, 20 MAJ - Ish-ministri i Shëndetësisë në Kosovë, Numan Baliq, është dënuar me dy vjet burgim, pasi është shpallur fajtor për veprën penale sulm seksual. Sipas "Betimit për drejtësi", Baliqit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak. Sipas aktgjyqimit të shpallur të enjten nga gjykatësi Shaqë Curri, Baliqit i është shqiptuar edhe dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të profesionit të mjekut në periudhë prej dy vjetëve.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur në tetor të vitit të kaluar, Baliq kishte thënë se nuk ndihet fajtor për veprën që është akuzuar nga Prokuroria Themelore e Pejës. Sipas aktakuzës së 29 shtatorit të vitit 2020, Baliq akuzohet se më 12 gusht të atij viti me dashje, e në cilësi të profesionistit shëndetësor ka keqpërdorur gjendjen shëndetësore të viktimës A. I. dhe i ka kërkuar që ta prekë me qëllim seksual pa pëlqimin e saj, ndërkohë që viktimë atë natë ka qenë duke

e shoqëruar foshnjën gjashtëmuajshe, të hospitalizuar në repartin e ortopedisë.

Lajmi për vendimin ndaj Baliqit vjen pak ditë pasi mediat lokale në Kosovë kanë shpërndarë një video ku pretendohet për ngacmim seksual të një të miture nga tre fëmijë në oborrin e shkollës "Faik Konica" në Prishtinë.

Më 19 maj dhjetëra nxënës dhe përfaqësues të shoqërisë civile kanë protestuar para Ministrisë së Arsimit duke kërkuar siguri më të madhe



për vajzat në shkolla. Protestuesit kanë kërkuar futjen e lëndës së Edukatës seksuale në planprogramin

arsimor, ambiente të sigurta për nxënësit, dhe angazhimin e punëtorëve socialë dhe të psikologëve në shkolla.

OAK-u paraqet rekomandimet e saj në Komisionin për Punë të Jashtme dhe Diasporë



PRISHTINË, 20 MAJ (ER) - Problemet e bizneseve me ambasadat, specifikisht kërkesa për rritjen e komunikimit reciprok, mungesa e atasheve ekonomikë, tërheqja e investimeve të huaja nga Diaspora, krijimi i kushteve dhe ofertave për investitorët si dhe problemet me licencimin

e pagesave ndërkombëtare në mesin e të cilave edhe PayPal, ishin çështjet kryesore të cilat u diskutuan në takim në mes të përfaqësuesve të OAK-së dhe kryetarit të Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Haki Abazi.

Sekretari i Bordit të OAK-së, Diamant Elshani, ka shpalosur aktivitetet dhe prioritetet e

OAK-së. Elshani ka theksuar se OAK-u ka analizuar planin qeverisës dhe ka përsëritur disa nga pikat e parapara në mesin e të cilave pikën për emitimin e bono thesarit dedikuar mërgatës, krijimin e Bankës Zhvillimore, duke shtuar që e shohin si shumë të nevojshme pikën që parashihet rivlerësimin e MSA-së si dhe e

përkrahin liberalizimin e tregut të punës me Shqipërinë. Elshani ka shprehur gatishmërinë e OAK-së për të dhënë kontribut në aspektet profesionale që ndërliken në fushat me interes reciprok. Përderisa kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Haki Abazi, ka falënderuar OAK-në për

takimin konstruktiv duke theksuar se janë të hapur për bashkëpunim. Abazi ka theksuar se çdo kërkesë e odës që i përket këtij Komisioni, do të merret në shqyrtim. Sa i përket prezantimit të planit qeverisës, Elshani ka theksuar se ka shumë pika në të cilat mund të ndërliken dhe të kontribuojnë si Odë.

Dialogu me Doganën, i rëndësishëm për lehtësimin e operacioneve biznesore



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 MAJ - Dogana është një ndër aktorët më të rëndësishëm për sektorin privat dhe operacionet e bizneseve. Me qëllim të lehtësimit të dialogut midis kompanive të sektorit privat dhe Doganës, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar tryezë diskutimi me drejtorin e ri të përgjithshëm

të Doganës së Kosovës.

Agron Llugaliu, drejtor i përgjithshëm në Doganën e Kosovës, ka thënë se synimi i Doganës është krijimi i kushteve për trajtimin e barabartë për të gjitha bizneset dhe lehtësimi i procedurave doganore përmes avancimeve teknologjike, respektivisht automatizimit të proceseve, që ofrojnë komunikim dhe qasje më të lehtë për bizneset në proceset e zhvilluara nga

Dogana. Ai më tutje ka theksuar se ndihmë kryesore do t'u ofrojnë sektorit tregtar, prodhues dhe eksportit në vendin tonë.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë se Dogana është një ndër institucionet më me ndikim në punën e shumë ndërmarrjeve në vend, prandaj fuqizimi i dialogut me këtë institucion është interes i vazhdueshëm i sektorit privat dhe

i përfaqësuesve të tyre.

Avni Krasniqi, kryesues i Komitetit i Tregtisë dhe Doganës në Odën Amerikane, ka thënë se falë bashkëpunimit të ngushtë dhe dialogut të vazhdueshëm me Doganën e Kosovës, është bërë e mundur të lehtësohen në vazhdimësi procedurat e zhdoganimit të mallrave dhe procedurat e tjera që lidhen me Doganën, duke theksuar se ky institucion është shembull në

tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Përfaqësuesit e ndërmarrjeve të pranishme në takim ngritën shqetësime të ndryshme që lidhen me rolin e Doganës si çështja e rivlerësimit dhe klasifikimit të mallrave, trajtimin e importeve paralele dhe mbrojtjes së pronësisë intelektuale, por edhe luftimin e ekonomisë joformale dhe kontrabandës.

Lansohet AgromarketKS, treg online për fermerët

PRISHTINË, 20 MAJ (ER) - Fermerët e Kosovës tashmë do ta kenë në dispozicion tregun e tyre online, në të cilin do ta kenë më të lehtë shitjen e prodhimeve të tyre bujqësore. Platforma AgromarketKS është projekti më i ri digjital i cili do t'u vijë në mbështetje fermerëve dhe funksionon si treg i gjelbër online. Kjo platformë është zhvilluar në kuadër të projektit "Zhvillimi i komunitetit për përmirësim të mirëqenies dhe ndërtim të besimit", që mbështetet nga Agjencia për Bashkëpunim Ndërkombëtar e Japonisë (JICA).

Me këtë rast, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka ftuar të gjithë fermerët, konsumatorët dhe ndërmarrjet tregtare dhe agro-përpunuese që ta shfrytëzojnë këtë platformë me qëllim të promovimit dhe konsumimit të prodhimeve vendore bujqësore. "Të gjithë kultivuesit e perimeve, frutave, frutave të imta, si dhe përpunuesit e produkteve të

bulmetit dhe produkteve të tjera ushqimore kanë mundësi ta përdorin këtë platformë e ju mundëson të shesin kudo në Kosovë e jo vetëm brenda komunave ku veprojnë. Platforma AgromarketKS do të jetë lehtësisht e përdorshme si nga shitësit, po ashtu edhe nga blerësit. Platforma është lansuar gjatë muajit maj 2021. Të gjithë fermerët ftohen të regjistrohen dhe ta krijojnë profilin dhe produktet që ofrojnë. Në anën tjetër, blerësit, qofshin ata individë apo biznese, po ashtu ftohen të regjistrohen për ta krijuar kontaktin direkt me fermerët. AgromarketKS do të jetë funksionale 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Bujqësisë.

Më tutje, në njoftim thuhet se "Projekti AgromarketKS është përkrahje shtesë për fermerët e dëmtuar nga pandemia e Covid-19". "Projekti implementohet nga Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës - G7 dhe kompania



për konsulencë të biznesit Sigma BMC. Projekti ka edhe mbështetjen e përfaqësuesve të shoqatave të fermerëve, qeverisjes lokale dhe OJQ-ve nga komunat Gjakovë, Suharekë, Partesh dhe Shtërpcë, të cilët janë trajnuar

gjatë tre vjetëve të fundit nga JICA dhe luajnë rol ndërlidhës mes fermerëve dhe projektit", theksohet në njoftim.

Mes të tjerash, në njoftim thuhet se: "Me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëri e platformës dhe në vazhdimësi

të përkrahjes së fermerëve dhe promovimit të prodhimeve vendore, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është zotuar që ta përkrahë në vazhdimësi këtë projekt pas përfundimit të përkrahjes nga JICA".

Punëtorët e ATK-së në grevë, pezullohen shërbimet për një orë



Prishtinë, 20 maj (ER) - Sindikata e Punëtorëve e Administratës Tatimore e Kosovës ka mbajtur të enjten

grevë njëorëshe, duke i ndërprerë të gjitha shërbimet për tatimpaguesit.

Sekretari i Sindikatës i

Punëtorëve të ATK-së, Arlinda Bajraj, ka deklaruar se arsyeja për mbajtjen e kësaj greve ka ardhur si rezultat i neglizhimit

dhe mosrealizimit të kërkesave të tyre.

"Kjo është ndër mënyrat tona që kemi paraqitur shqetësimet

tona si sindikatë. Ishte një grevë njëorëshe. Tashmë përfundoi greva që është mbajtur në të gjitha regjionet. Deri në këtë grevë kemi arritur sepse ka një kohë të gjatë që kemi paraqitur pakënaqësitë tatimore kërkesa që janë të kahershme. Kërkesë kryesore e stafit është ndërrimi i statusit të Administratës Tatimore e cila është një agjenci ekzekutive dhe propozoj që të ndërrohet në Kuvend dhe të kalohet në agjencinë e pavarur", ka thënë Bajraj.

Ai ka treguar se kërkesat kryesore të kësaj sindikate janë: Krijimi i kushteve të punës, propozimndryshimi i statusit të Administratës Tatimore të Kosovës nga agjenci ekzekutive në agjenci me status të veçantë, kompensimet e tjera të shpenzimeve (sipas kërkesave paraprake), përfshirja në pakon fiskale të gjithë stafi i ATK-së.

Murati: Janë ngrirë rreth një milion euro, dyshohet për shpëlarje parash dhe financim të terrorizmit

Prishtinë, 20 maj - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, në një konferencë për media, ka thënë se kanë bërë identifikimin e disa transfereve të dyshimta si dhe pagesa të dyfishta të parregullta. Ai ka thënë se

janë rreth një milion euro që kanë të bëjnë me shpëlarje të parash dhe me financim të terrorizmit. "Kemi bërë identifikimin e disa transfereve të dyshimta, ku janë identifikuar prej barazimit që kemi kërkuar më 11 maj. Ka edhe raste të

tjera ku ka pasur pagesë të dyfishtë dhe të parregullt. Keqblerësit do t'i ndjekim deri në fund. Është ngrirë edhe një shumë rreth një milion euro, që dyshohet se ka të bëjë me shpëlarje të parave dhe financim të terrorizmit", ka thënë Murati.



ALBIN KURTI DHE ÇLIRIMI I KOSOVËS NGA KRIMINELËT



Shkruan: Ismail SYLA

1. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e zgjodhi pasdarken e Brukselit të 19 majit 2021 për të përcuar një mesazh gjoja mjegullor në sipërfaqe dhe shumë të qartë në adresim. I gjendur në një pozicion prej të lazdruari midis kohës kur konopi i fillimit të dialogut me Serbinë po mblidhet dita-ditës dhe luajtja e rolit se ai dialog fillon jo kur të dojë Brukseli e jo kur të dojë Serbia, por atëherë kur të dojë Albini, kryeministri i Kosovës po hiqet i forti i këtij trekëndëshi. Me një fjalor të fryrë tautologjik dhe demagogjik nga Brukseli lansoi gjetje tipologjike për dy natyra kriminelësh: të luftës dhe të paqes. Kjo tipologji nuk mund të kamuflon me nënkuptim as universal as ballkanik, por është një goditje aspak e sofistikuara ndaj lidershit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

2. Është fatkeqësi e madhe kur armiqësia ndaj lidershit të UÇK-së pa pikë hezitimi, ngurrimi dhe turpi vjen nga liderët politikë shqiptarë. Është e kuptueshme që kundër lidershit të UÇK-së të jetë Serbia, sepse guximi, vizionariteti dhe përkushtimi jetësor i liderëve të UÇK-së ka bërë që sundimi serb i Beogradit të goditet në dy pikat kyçe të saj: mbi ushtrinë dhe policinë serbe. Këtë goditje, gëgjësisht çlirim dhe humbjen e Kosovës Beogradi zyrtar kurrë nuk ua falë atyre që e kurorëzuan përpjekjen shekullore të shqiptarëve të Kosovës. U pa që edhe pas 20 vjetësh nga çlirimi i Kosovës, por as pas 200 e 2000 mijë vjetësh Serbia nuk ua falë kokat atyre që ia nxorën nga dora Kosovën më 12 qershor 1999.

3. Është fatkeqësi e madhe që shteti i Kosovës ka pësuar rrëshqitjen e madhe antihistorike. Deri para dy vjetësh Kosova kishte në krye të institucioneve liderë të dalë nga radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Së paku një institucion ishte kryekrejt i drejtuar nga figura të dala prej UÇK-së. Ishte doktori i luftës çlirimtare, Bajram Rexhepi

kryeministër i qeverisë konsensuale të viteve 2001 - 2004. Ishin Ramush Haradinaj dhe Agim Çeku kryeministra në periudhën 2004 - 2007. I dalë si lider politik i fuqishëm nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës Hashim Thaçi ishte kryeministër, i cili drejtoi qeverinë e Kosovës, qeverinë e shpalljes së pavarësisë dhe modernizimit infrastrukturor prej viti 2008 deri më 2015. Në një periudhë të tri institucioneve qendrore, Presidenca, Kryeministria dhe Kuvendi i Kosovës drejtoheshin nga liderë të UÇK-së: nga Hashim Thaçi, Ramush Haradinaj dhe Kadri Veseli.

4. Sot institucionet kryesore të Kosovës janë të spastruara dhe të sterilizuara, pra pa asnjë lider a personalitet të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sot institucionet e Kosovës drejtohen nga figura pa asnjë histori dhe pa asnjë trashëgimi esenciale në raport me betejat e gjata dhe përpjekjet për lirinë dhe shtet ndërtimin e Kosovës. Ibrahim Rugova ishte presidenti i parë i Kosovës së çliruar, që prapa vetes kishte një histori të rezistencës paqësore të suksesshme. Hashim Thaçi, kryeministri më

me jetëgjatësi qeverisjeje në qeveritë e Kosovës deri më tani, President i Kosovës përreth pesë vjet, ka histori tejet të përmbushur si lider i gueriles më të suksesshme të shekullit njëzet, e vlerësuar nga historianë ushtarakë botërorë. Hashim Thaçi ishte lider politik i UÇK-së dhe kryesues i delegacionit të Kosovës në Konferencën Ndërkombëtare në Ramboulet-it. Jakup Krasniqi, zëdhënësi i parë i UÇK-së, veprimtar mbi dyzet vjeçar i çështjes kombëtare, ishte me të drejtë kryetar i Kuvendit të Kosovës. Kadri Veseli, po ashtu kryetar i Kuvendit të Kosovës, ishte njëri nga themeluesit dhe drejtuesit kryesorë të UÇK-së, suksesi i së cilës nuk mund të paramendohet pa punën, talentin dhe zotësinë e tij.

5. Cila është trashëgimia politike e liderëve aktualë të institucioneve kryesore të vendit? Unë nuk mbaj mend ndonjë gjë. Karrierë e ndërtuar duke përgojuar një institucion të UÇK-së me shkurtesën SHIK. Rrokullisja e Toyota-ve të UNMIK-ut, gazi lotsjellës në Kuvend, gjuajtja me vezë, përcmimi i flamurit të Kosovës, mos ngritja në këmbë kur intonohej himni i flamurit të

Kosovës. Asnjë projekt i madh nacional nuk lidhet me emrin e Albin Kurtit. Edhe demonstrata e 1 Tetorit 1997 shpërfaqti dy emra tjerë, Bujar Dugollin nga radha e studentëve dhe Ejup Statovcin, nga radha e Universitetit. Sa për trashëgiminë dhe biografinë politike të Vjosës dhe Glaukut do të vlen të ajo formula folklorike nekrologjike më e shkurtra në botë për njeriun që gjithçka bëri në jetë ishte "hangër fiq e diq".

6. Sipas deklaratës së kryeministrit të Kosovës në pasdarken e Brukselit Kosova është në rrugë të mirë të kryerjes së obligimeve, që pëlqehen edhe nga demokracia evropiane. Kriminelët e luftës në Kosovë nuk janë strukturat ushtarake e policore serbe, por Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Ai foli edhe për praninë e kriminelëve edhe në partitë politike. I bie që PDK-ja është "çliruar" nga kriminelët politikë meqë ish-lideri i saj Hashim Thaçi, dhe ish-kryetari i saj Kadri Veseli, janë të burgosur tashmë. Për "kriminelët" e partive tjera shqiptare të Kosovës, do të kursehem në përmendje emrash. Shpresoj se ndoshta nënkuptohen.

Informohen nxënësit për sigurinë në trafik dhe lëvizjet në rrugë

PRISHTINË, 20 MAJ (ER) - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, bashkë me Policinë e Kosovës, Kolegjin "Tempulli" dhe Asociacionin Kosovar të Motorizimit "AMRKS", kanë bërë mbylljen e Javës së 6-të Globale për Siguri Rrugore e Kombeve të Bashkuara. Së bashku me nxënësit e ShFMU "Dardania" të enjten marshuan në shtegun e biçikletave në lagjen Dardania ku shpejtësia e lëvizjes ishte 30 km në orë, nën përkujdesjen dhe përcjelljen e Policisë së Kosovës. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Policia e Kosovës dhe Aktivistët e AMRKS-së, informuan nxënësit pjesëmarrës për sigurinë e lëvizjes së tyre në rrugë si dhe u bë shpërndarja e fletoreve ilustruese me situata të fëmijëve në trafik, fletore të thjeshta, vizore dhe ngjyra.





Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfin", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.


5.99€

ISBN 978-9951-780-56-8



Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE





QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Zeqiri la Kosovën për Zvicrën, 'dardanët' e shpallin 'non grata'

PRISHTINË, 20 MAJ - Futbollisti shqiptar me prejardhje nga Kosova, Andi Zeqiri, e ka zgjedhur për ta përfaqësuar Kombëtaren e Zvicrës. Ky veprim i futbollistit Zeqiri nuk u ka pëlqyer aspak tifozëve të Kosovës - "dardanëve" - të cilët kanë vendosur që ta shpallin person "non grata" Zeqirin. Tifozët e kanë quajtur tradhti largimin e tij, duke thënë se këtë kalim e bëri në pabesi. "Mashtimet nuk tolerohen. Ai i Andit nuk ishte vetëm mashtim ndaj federatës, por edhe ndaj tifozëve dhe mbarë popullit në Kosovë. Si i tillë mori përmasa edhe më të

rënda. Ofendoj shumë keq të gjithë ata që u përpoqën ta afronin te Kosova", thuhet në reagimin e "dardanëve". "Tani, ky zotëri i veshur me sedër të huaj, atë zvicerane, le të na tregojë se çka e motivoi për ta bërë këtë tradhti? Çfarë i bëri Kosova që t'ia linte këtë njollë të zezë? Çka i kishim borxh ne tifozët që ai të na përgjigjej me atë sjellje perverse? Nënshkruajti mbi dokument se do t'i bashkohej kombëtarës kosovare, pastaj si skuth i pabesë në pabesi shkoi te Zvicra. Të pabesët nuk i duhen Kosovës. Nuk u janë dashur shqiptarëve. Vetëm se,

ta kesh të qartë një gjë: për 'Dardanët' je i padëshiruar - 'non grata'. Kënaqu në alpet zvicerane, por mos u mendo asnjëherë të identifikohesh me shqiptarët dhe Kosovën, sepse atë mundësi për t'u identifikuar si i tillë e hodhe në kosh të plehrave. Kurse për neve ti je vetëm një gërmadhë mbeturinash. Nuk e meriton asnjë respekt! Dy vjet duke sorollatur njerëz, duke i gënjer dhe vendosur në pozita të padobishme. Prandaj për ne 'Dardanët' je i shpallur 'non grata!', thuhet në reagimin e tifozëve të Përfaqësueses së Kosovës.



Elhami Shabani, i shtati në Evropë



Prishtinë, 20 maj - Elhami Shabani ka arritur deri në çerekfinale të Kampionatit Evropian të Karatesë që mbahet në Poreç të Kroacisë. Karateisti i Kosovës përfundoi në vendin e shtatë të kategorisë deri në 75 kilogramë. Shabani kaloi tri raunde, përfshirë raundin e parë në të cilin kaloi pa luftë. Në raundin e dytë mundi Jakub Matejka të Republikës

së Çekisë, ndërsa në raundin e tretë fitoi ndaj turkut, Erman Eltemur, i teti në renditjen olimpikë. Elhamiu u ndal në çerekfinale nga ukrainasi Stanislav Horuna, i pesti në renditjen olimpikë "Tokyo 2020". Garuesi i Kosovës pati rastin të hyjë në garë për medaljen e bronzit, por në repesazh pësoi humbje nga holandezi Timothy Petersen. Të enjten garuan edhe

karateistët e tjerë. Fortesa Orana (+68 kg) dhe Herolind Nishevci (+84 kg) arritën suksesin më të madh, duke qenë një fitore larg medaljes së bronzit, lufta këto që zhvillohen të dielën. Benjamin Shabani shënoi një fitore në kategorinë -84 kg. Diellza Sejdiqaj (-68 kg) u ndal në raundin e parë, ndërsa Adelina Rama (-61 kg) në të dytin.

Stadiumi 'Ismet Shabani' bëhet shkollë, reagon FC Ferizaj

Ferizaj, 20 maj - Në stadiumin e qytetit "Ismet Shabani" në Ferizaj ka filluar ndërtimi i një shkolle. Klubi i Ferizajt nëpërmjet faqes zyrtare ka reaguar duke shfaqur pakënaqësi. "Stadiumi i qytetit 'Ismet Shabani' bëhet shkollë. Stadiumi i qytetit, kur më herët ishte arenë e

futbollit, ku çdo javë ishte i stërmbushur me tifozë, tani është shëndërruar në shkollë. Në këtë stadium kanë dalë shumë talente nga qyteti ynë e shumë gjenerata kanë luajtur këtu. Tani kjo fushë më nuk do të ekzistojë pasi aty do të ndërtohet një shkollë! Ne si klub jemi të habitur për këtë



gjë dhe kërkohet që dikush të japë përgjegjësi për këtë që po

ndodh. Qyteti ynë jeton për futboll. Meritojmë më shumë",

thuhet në reagimin e FC Ferizaj.

Presidenti i FIFA-s uron Prishtinën për titullin e kampionit

Prishtinë, 20 maj - Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, i ka dërguar një telegram presidentit të FFK-së, Agim Ademi, nëpërmjet të cilit e ka uruar FC Prishtinën për titullin e kampionit në Superligën e Kosovës si dhe ka falënderuar FFK-në për zhvillimin dhe prosperitetin e futbollit në Kosovë. "I nderuar president, ju lutem më lejoni të përgëzoj FC Prishtinën që

u kurorëzua kampion i Kosovës për edicionin 2020/21! Ky titull pa dyshim është rezultat i punës së palodhshme, pasionit dhe përkushtimit të madh, prandaj të gjithë në klub mund të jenë krenarë për këtë arritje të rëndësishme. Do të isha mirënjohës nëse përgëzimet e mia ua përcillni të gjithë të përfshirëve në klub, të cilët i inkurajoj të vazhdojnë të punojnë me

frymën e ekipit dhe me pasion dhe vendosmëri. Në emër të komunitetit ndërkombëtar të futbollit, përfitoj nga ky rast t'ju falënderoj ju dhe federatën tuaj për kontributin në zhvillimin dhe prosperitetin e futbollit në Kosovë, në rajonin tuaj dhe kudo në botë. Pres që të shihemi së shpejti përsëri!", thuhet në letrën e urimit të Gianni Infantinos.



FIFA ishte aleate e fshehtë e Superligës Evropiane

NJU-JORK, 20 MAJ - Gazeta e njohur amerikane "New York Times" ka zbuluar disa informacione të rëndësishme për Superligën Evropiane. Pasi analizuan kontratat mes klubeve, gazeta pretendon se këtë projekt e ka ditur edhe FIFA, që ishte aleate e fshehtë.

Detaji që bie në kontrast me qëndrimin e presidentit Gianni Infantino pas njoftimit të 12 klubeve, është sepse klubet ishin në kontakt të vazhdueshëm me numrin një të FIFA-s dhe këtë ia kishin konfirmuar gazetës disa njerëz që ishin të afërt me

presidentin. "New York Times" tutje zbulon se Superliga Evropiane dhe FIFA kishin provuar që klubet pjesëmarrëse të merrnin pjesë në një "Kupë Botërore të Klubeve së Botës", që ishte kërkesë e veçantë nga Infantino, ky i fundit do ta

kishte bindur bankën amerikane "JP Morgan" të investojë një në turne që do të 'prodhohej' nga Florentino Perez dhe Andrea Anjelli. Por, të gjitha për një moment u mohuan nga presidenti i FIFA-së, që i ndihmoi UEFA-së ta mbyllë Superligën Evropiane.



Ndërkohë, në Superligën Evropiane vazhdojnë të mbesin vetëm Real Madridi, Barcelona dhe Juventusit.

6 shqiptarë në listën e Maqedonisë së Veriut për Kampionatin Evropian

Shkup, 20 maj - Gjashtë futbollistë shqiptarë do ta përfaqësojnë Maqedoninë e Veriut në Kampionatin Evropian "Euro 2020". Trajneri Igor Angelovski e ka publikuar listën e gjerë të 26 futbollistëve të ftuar për Evropian, ndërsa aty figurojnë edhe emrat e mbrojtësve Visar Musliu, Egzon Bejtullai e Ezgjan Alioski dhe të mesfushorëve Arijan Ademi, Enis Bardhi e Ferhan Hasani. Maqedonia e Veriut e siguroi kualifikimin e parë dhe historik në Evropian pasi në gjysmëfinale të "play-off"-it të Ligës së Kombeve e mposhti Kosovën e në finale Gjeorgjinë. Kampionati Evropian do të mbahet nga 11 qershori deri më 11 korrik. Maqedonia e Veriut gjendet në Grupin C së bashku me Holandën, Ukrainën dhe Austrinë. Maqedonasit do të luajnë me Austrinë më 13 qershor, me Ukrainën më 17 dhe me Holandën më 21 të muajit që vjen. Pra, krahas shqiptarëve të Zvicrës, në Evropian do t'i shohim edhe ata të Maqedonisë së Veriut.



Lista e futbollistëve:

Portierë: Stole Dimitrievski (Rayo Vallecano), Damjan Shishkovski (Doxa), Riste Jankov (Rabotnicki Skopje).
Mbrojtës: Stefan Ristovski (Dinamo Zagreb), Visar Musliu (Fehervar), Egzon Bejtullai (Shkendija), Kire Ristevski (Ujpest), Gjoko Zajkov (Charleroi), Darko Velkovski (Rijeka), Ezgjan Alioski (Leeds United).
Mesfushorë: Arijan Ademi (Dinamo Zagreb), Enis Bardhi (Levante), Stefan Spirovski (AEK Lamaca), Boban Nikolov (Lecce), Tihomir Kostadinov (Ruzomberok), Ferhan Hasani (Partizani Tirana), Eljif Elmaz (Napoli), Daniel Avramovski (Kayzerispor), Darko Churlinov (Vfb Stuttgart), Marjan Radeski (Akademija Pandev).
Sulmues: Goran Pandev (Genoa), Aleksandar Trajkovski (Real Mallorca), Ivan Trichkovski (AEK Lamaca), Vlatko Stojanovski (Chambly), Krste Velkovski (Sarajevo), Milan Ristovski (Spartak Trnava).

Lakersat sigurojnë 'play-off'-in

LOS ANGELES, 20 MAJ - Los Angeles ka arritur ta fitojë ndeshjen e "play-in"-it ndaj Golden State Warriorsit. Kampioni në fuqi fitoi me rezultat të ngushtë 103:100 dhe me këtë fitore ka siguruar pjesëmarrjen në "play-off". Deri te kjo fitore lakersat erdhën falë treshes vendimtare të shënuar nga LeBron James dhe deri në fund të ndeshjes administruan mirë rezultat. Koshshënuesi më i mirë te lakersat ishte Anthony Davis me 25 pikë e 12 kërcime. Ndërkohë LeBron Jamesi arriti "triple-double" me 22 pikë, 11 kërcime e 10 asistime. Stephen Curry ishte më i miri te Warriorsit me 37 pikë, por që nuk mjaftuan për fitore. Dueli tjetër i "play-in"-it mes Memphis Grizzliesit dhe San Antonio Spursit u takoi vendasve me rezultat 100:96. Lakersat tani në



raundin e parë të "play-off"-it takohen me Phoenix Suns. Ndërkohë Memphisit dhe Golden State Warriorsit do të luajnë një tjetër ndeshje mes vete ku fituesi luan me Utah Jazzin.

Barcelona, 14 futbollistëve: Ulni rrogat ose largohuni

Afati kalimtar i verës do të jetë shumë intensiv për Barcelonën. Tifozët shpresojnë që Leo Messi të rinovojë dhe ekipi i tyre i zëmër të nisë një cikël të ri fitues me Joan Laportën si president. Ky i fundit ka vendosur të bëjë një revolucion të vërtetë në fund

të sezonit. "Sport.es" raporton se plot 14 lojtarë mund të largohen nga "Camp Nou", mes tyre edhe emra të rëndësishëm. Barcelona po kalon një moment të vështirë ekonomik dhe drejtuesit e klubit po krijojnë një plan për t'i ulur shpenzimet e shumta. Në

listën e përpiluar janë 14 futbollistë, të cilëve do t'u kërkohet ulja e rrogës. Kush nuk pranon do të përfundojë në merkato. Lojtarë si Pique, Jordi Alba, Busquets apo Sergio Roberts, duhet të bëjnë një sakrificë financiare për ta vijuar karrierën te Barcelona.

Diskutim i ndryshëm për Riqui, Neto, Umtiti, Junior, Pjanic, Coutinho, Griezmann, Matheus, Braithwaite dhe Dembele. Këta dhjetë futbollistë ndodhen zyrtarisht në merkato dhe klubi katalanas shpreson të përfitojë sa më shumë nga shitjet e tyre.

SHKURT

Mustafi largohet nga Schalke 04

Përvoja e futbollistit shqiptar Shkodran Mustafit në Schalke 04 ka zgjatur shumë pak. Në fakt, Mustafi do të largohet nga ekipi gjerman pas vetëm një sezoni. Përfaqësuesi gjerman u largua verën e kaluar nga Arsenalit dhe në Schalke u konsiderua si një përforcim i madh. Mirëpo, ai bëri paraqitje të zbehta, njëjtë si ekipi në përgjithësi, i cili ra nga Bundesliga. Schalke përmes një njoftimi në uebfaqen zyrtare zbuloi se 10 futbollistë dhe tre anëtarë të stadiut do të largohen me të përfunduar sezoni aktual. "Schalke ju uron lojtarëve dhe anëtarëve të stafit më të mirën në jetën e tyre private dhe profesionale në të ardhmen", ka njoftuar klubi gjerman.

Perezi me Red Bull 'fluturon' në Montekarlo, Ferrari probleme për Leclerc

Sergio Perez me Red Bullin ka qenë më i shpejtë sot në sesionin e parë të provave të lira, të zhvilluara në pistën e Montekarlo, ku ditën e diel do të zhvillohet gara e Çmimit të Madh të Monako në Formula 1. Meksikani dha kohën 1'12"487, duke lënë pas spanjollin e Ferrarit, Carlos Sainz. Ndërsa i treti u rendit holandezi Max Verstappen me makinën tjetër Red Bull. Në vendet 5-6 u klasifikuan dy makinat Mercedes, me Lewis Hamiltonin që u rendit para shokut të tij të skuadrës, Valtteri Bottas. Probleme për Ferrarin e Charles Leclerc, që zhvilloi vetëm 4 xhiro e më pas u tërhoq për shkak të një problemi në kambio. Probleme edhe për Alonson (14-ti), që u përplas me barrierat mbrojtëse. Provat zyrtare do të zhvillohen ditën e shtunë.

Pirlo: Nuk dua të largohem nga Juve

Juventusit është shpallur kampion i Kupës së Italisë pasi e ka mundur Atalantan me rezultat 2-1. E ardhmja e Andrea Pirlon në stolin e Juventusit është vënë në pikëpyetje disa herë brenda këtij sezoni. Mirëpo, tekniku italian është shprehur se dëshiron të qëndrojë te "Zonja e Vjetër". "Unë dua të qëndroj këtu, për këtë kam ardhur. E dashuroj futbollin, mirëpo edhe pse dëshiroj qëndrimin, bordi duhet të vendosë për këtë", ka thënë Pirlo për "Rai Sport".

Shtatë persona akuzohen për vdekjen e Maradonës

Shtatë persona janë të dyshuar dhe akuzohen për vrasje me qëllim të Diego Armando Maradonës. Të akuzuarit janë mjekë që i erdhën në ndihmë Maradonës përpara vdekjes së tij nga një atak kardiak më 25 nëntor të vitit të kaluar dhe do të paraqesin kundër akuzat drejt tyre në 31 maj. Në fillim të këtij muaji, një panel ekspertësh mjekësorë konkluduan se puna e mjekëve ishte e "papërshtatshme dhe e mangët". Tani, nëse kjo ngjarje zbardhet, këta persona rrezikojnë të dënohen nga 8 deri në 25 vjet burg.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Prishtinë, 20.05.2021

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 30, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, neni 32, Ligjit të Punës nr. 03/L212, Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Rregullores për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve në Institutin e Historisë shpallë:

KONKURS

1. (Një) hulumtues i pavarur për fundin e shek. XIX fillimin i shek. XX - zgjedhje/rizgjedhje

Kandidatët për hulumtues të pavarur duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të ketë të regjistruara studimet e doktoratës për periudhën përkatëse,
- Të ketë punime të publikuara në revista shkencore nga periudha e caktuar,
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit,
- Njohja e gjuhës së huaj është përparësi.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:


- Vërtetimin për vijimin e studimeve të doktoratës,
- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse (MA),
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk janë nën hetime,
- CV të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/512-303, prej orës 09:00 - 16:00.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti i Historisë në Prishtinë, (Ndërtesa e re e Institutit të Historisë në afërsi të Institutit Albanologjik të Prishtinës).



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Prishtinë, 20.07.2020

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučnoistraživačkoj djelatnosti - (Službene Novine Republike Kosova, br 11/02 Maj 2013), Član 30, Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini, član 33 stav 5, član 51 i 52 obavljuje, Zakon Br. 03/L-212 o Radu, Administrativno Uputstvo (MRSZ) BR.07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru, objaviti:

KONKURS

- 1 (Jedan) Nezavisni istraživači za kraj XIX veka - početak XX veka- izbor/reizbor

Kandidati za Nezavisna istraživač moraju ispuniti ove uslove:

- Upisane doktorske studije za navedeni period.
- Objavljene radove u naučnim časopisima iz navedenog perioda;
- Da su učestvovali u naučnim aktivnostima u zemlji i u inostranstvu.
- Poznavanje stranih jezika je prioritet.

Potrebna dokumentacija:

Kandidati treba da dostave sledeću dokumentaciju:

- Potvrda koja dokazuje da pohađa doktorske studije,
- Diploma za završetak relevantnih studija (MA)
- Izvod iz matične knjige rođenih koji nije stariji od šest meseci,
- Dokument izdat od nadležnog organa koji potvrđuje da nisu pod istragom,
- CV o čemu mora priložiti neophodne dokaze kako bi se dokazala situacija u njoj.

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja u dnevnim novinama, Aplikaciji se prilažu (dodajte) kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koju zahteva radno mesto za koje se aplicira.

Kandidati izabrani na izbornoj listi će biti obavješteni u pisanom obliku ili putem telefona u zakonskom roku Instituta i dužni su da sa sobom daju originalne dokumente o kvalifikacijama i obuci koja se provode za verifikaciju pred Komisijom.

Za detaljnije informacije možete se obratiti na ovom Br . Tel: 038 / 512 303, od 09:00 do 16:00 časova.

Kompletirani zahtevi dostavljaju se na adresu: Institut Istorije u Prištini, bez broja (Novi Objekat u blizini Instituta Albanologjik i Prishtinës).

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Petrit Halitjaha shpall te pavlefshme dëftesat diplomën certifikaten shmlë " Ymer Prizreni .

► Avdi Ajazaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Hajriz Hajdari Shpalle te pavlefshme deftesen e shkollës fillore "Xhevat Jusufi"

► Nebih Zeneli shpalle te pavlefshme diplomën dhe deftesat e SHMLE " Hasan Prishtina "

► Liridon Musliu shpalle te pavlefshme deftesat dhe diplomën e SHMLM "Dr Xheladin Deda"

► Liridon Musliu shpalle te pavlefshme licensen e punës me numer : KO-21039-05-02 lëshuar nka OIK

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



22 vjet nga shuarja e martirit

Baki Bela (1927-1999)

Sot u bënë 22 vjet që nga shuarja e martirit të luftës së Kosovës të vitit 1999.

Sot, në këtë ditë dhembje dhe krenarie, kujtimet tona na thonë se të gjithë të rënët e luftës janë meritore për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

**Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës!
E përkujton i biri Xhemail Bela me familje nga Beljant e Kaçanikut.**

